

## NJOFTIM PËR SHTYP

Shoqëria KESH sh.a me datë 16 Maj 2016 ka depozituar në Entin Rregullator të Energjisë aplikimin për tarifën me të cilën do të shesë energjinë elektrike tek OSHEE/Furnizuesi i Shërbimit Universal të Energjisë Elektrike për periudhën 01 Korrik – 31 Dhjetor 2016.

Aplikimi për Tarifë për periudhën 01 Korrik – 31 Dhjetor 2016 është hartuar duke u bazuar në parashikimet e ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike". Gjithashtu përlogaritja e tarifës nga KESH sh.a është kryer duke marrë parasysh frymën e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare me vendimin Nr. 171, datë 25.02.2015 "Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike".

Në aplikimin e KESH sh.a. për tarifë të paraqitur në ERE për periudhën 01.07.2016-31.12.2016, shoqëria KESH sh.a ka parashikuar mbulimin e shpenzimeve operative, kostos kapitale, kryerjen e investimeve si edhe shlyerjen e detyrimeve që kanë lindur nga ushtrimi i deritanishëm i funksionit të Furnizuesit Publik me Shumicë, funksion të cilin referuar VKM 244/2016 nuk do ta kryejë më duke filluar nga data 01.07.2016.

Referuar sa më sipër, nëpërmjet aplikimit të paraqitur në ERE për tarifën me të cilën do të shesë energjinë elektrike tek OSHEE/Furnizuesi i Shërbimit Universal të Energjisë Elektrike për periudhën 01 Korrik – 31 Dhjetor 2016, KESH sh.a parashikon:

- Uljen e tarifës aktuale me të cilën shoqëria KESH sh.a shet energji elektrike tek shoqëria OSHEE sh.a/Furnizuesi i Shërbimit Universal nga 3.00 lekë/kWh në 2.91 lekë/kWh;

Me miratimin nga ERE të tarifës së paraqitur nga KESH sh.a për periudhën 01 Korrik – 31 Dhjetor 2016, shoqëria KESH sh.a parashikon të realizojë një shfrytëzim optimal të njësive gjeneruese të energjisë elektrike, duke ofruar për klientët tariforë energji elektrike me kosto sa më të ulët dhe duke krijuar gjithashtu mundësinë e përmirësimit të situatës së vet financiare dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit të shoqërisë në tregun e reformuar të energjisë elektrike.

Aplikimi i KESH sh.a. për tarifë për periudhën 01.07.2016 - 31.12.2016 është publikuar nga Enti Rregullator i Energjisë në faqen zyrtare të internetit të ERE në linkun e mëposhtëm:

[http://ere.gov.al/doc/KESH\\_Aplikimi\\_per\\_Tarife\\_2016.pdf](http://ere.gov.al/doc/KESH_Aplikimi_per_Tarife_2016.pdf)